

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E FINANÇAVE / MINISTARSTVO ZA FINANSIJE / MINISTRY OF FINANCE	
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT / CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY	
Nr. Prot.	34/20
Org. Org.	AQP
Org. Unit	
Nr. I Fajve	1/32
Faj. Shtet	
No. Fajet	
Prishtinë / a	
Data : 28.02.2020	
Datum :	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije i Transfere - Ministry of Finance and Transfers

AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE / CENTRAL PROCUREMENT AGENCY

Analiza e kontratave te centralizuara të nënshkruara nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Ardi Mehmeti

Fation Alaj

Prishtinë, 2020

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	3
Qëllimet e Hulumtimit.....	3
Metodologjia	3
1. Udhëheqja dhe implementimi i prokurimeve te centralizuara nga AQP	4
1.1 Korniza ligjore.....	4
1.2 Implementimi i prokurimeve te centralizuara	4
2. Analiza e përfitimeve financiare	5
2.1 Kontratat publike – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira	5
2.2 Kontratat publike - Shfrytëzimi i veturave me qira.....	15
2.3 Kontratat publike kornizë – Shërbimet e Transportit Ajror	26
2.4 Kontratat publike kornizë – Furnizim me karburante.....	27
2.5 Kontratat publike kornizë – Furnizim me Mazut	30
Konkluzione	31
Rekomandime	32

Hyrje

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), sipas Ligjit për Prokurim Publik ne Kosove (LPP), ka autoritetin, kompetencat dhe përgjegjësitë të:

1. Grumbullon planifikimet finale te prokurimit nga te gjitha Autoritetet kontraktuese (AK), ne Kosove;
2. Udhëheqë dhe kryen prokurimet e centralizuara, për te gjitha AK-se ne Kosove, nëse autorizohet nga Ministri i Financave;
3. Çdo vit, përgatite dhe i dorëzon ne Ministrinë e Financave si draft, një liste te mallrave ose te artikujve, punëve ose shërbimeve te përdorimit te përbashkët, qe do te shpërblehen nga AQP, duke përdorur marrëveshjet kornize. Kjo liste e propozuar nga Ministria e Financave miratohet nga Qeveria në formën e një Udhëzimi Administrativ, brenda datës 31 janar te çdo viti;
4. Udhëheqë dhe kryen prokurime ne emër te AK-se, me kërkesën e AK –se dhe sipas një arsyetimi adekuat nga AK përkatës. Ministri i Financave, pas shqyrtimit te arsyetimit nga AK mund t'i lejoje AQP-se, kryerjen e aktivitetit te prokurimit;
5. Ndhmon AK, ne kryerjen e aktiviteve te prokurimit, me kërkesën e AK;
6. AQP, për çdo vit kalendarik përgatite dhe i dorëzon Ministrin te Financave, deri ne fund te muajit Shkurt te vitit vijues, një raport vjetor qe pasqyron aktivitetet e prokurimit te udhëhequra nga AQP për atë vit kalendarik.

Qëllimet e Hulumtimit

Qellim i këtij hulumtimi është te vlerësohen kontratat e centralizuara, duke i vlerësuar se a e kanë arritur qëllimin e tyre dhe a janë rezultatet e tyre në përputhshmëri me qëllimet e përgjithshme te prokurimit publik. Qëllimi kryesor është të shikohet se përmes këtyre kontratave a janë arritur kursime buxhetore.

Metodologjia

Në këtë punim metodologjia e përdorur do të jetë ajo komperative (krahasuese) në mes të çmimeve të kontratave që kanë qenë para hyrjes në fuqi të kontratave të centralizuara dhe gjithashtu krahasimi në mes të çmimeve të tregut dhe çmimeve të kontratave të centralizuara. Të dhënat janë siguruar nga mbledhja e të dhënave reale të deklaruara nga institucionet publike dhe operatorët ekonomik fitues të kontratave të centralizuara, nga raportet e auditimit dhe nga hulumtimi i tregut.

1. Udhëheqja dhe implementimi i prokurimeve te centralizuara nga AQP

1.1 Korniza ligjore

Duke marre në konsiderate përfitimet e pritura në shumë aspekte nga implementimi i prokurimeve te centralizuara dhe sidomos me një theks te veçante ne atë te kursimit te buxhetit te shtetit (te kursimeve financiare), Qeveria e Kosovës ne vazhdimësi dhe sidomos nga viti 2015, ka mbështetur implementimin e këtyre aktiviteteve te prokurimit.

Korniza legjislative e prokurimit publik ne Kosove e rregullon çështjen e implementimit te prokurimeve te centralizuara specifikisht ne *Nenet: 8, 9 dhe 95 te LPP-se*. Sidomos, një rendësi e veçante i është dhënë draftimit te një legjislacioni sa me efikas dhe gjithëpërfshirës, qe do e lehtësonte implementimin e aktiviteteve te prokurimit për prokurimet e centralizuara dhe ne këtë kontekst te implementimit te kontratave publike kornize. *Neni 38 i LPP-se*, si dhe legjislacioni mbështetës dytësore, rregullojnë anën legjislative te përdorimit te kontratave publike kornize, si një mjet efikas për implementim te një procedure te prokurimit, duke u mbështetur ne legjislacionin e BE-se për këtë çështje si dhe ne praktikrat me te mira te njohura.

1.2 Implementimi i prokurimeve te centralizuara

Duke filluar nga viti 2015, AQP, ka filluar ne mënyre me intensive implementimin e prokurimeve të centralizuara në nivel vendi. Me kalimin e viteve kontratat e centralizuara janë perfeksionuar dhe përdorimi i tyre vazhdon të shtrihet çdo herë e më shumë. Me qellim të realizimit sa më të mirë të prokurimeve të centralizuara AQP në vazhdimësi përcjell praktikrat e shteteve të Bashkimit Evropian.

2. Analiza e përfitimeve financiare

2.1 Kontratat publike – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira

Agjencia Qendrore e Prokurimi ne baze te Udhëzimit për Prokurime Qendrore ka zhvilluar procedurën e prokurimit Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira.

Pas konsultimeve te shumta dhe analizave AQP ka filluar me këtë procedurë duke arritur ne përfundim te saj te fitoj një kontrata ku çmimi për një kopje 0.0063€ respektivisht 0.0069€ pasi qe përmes kësaj procedure janë nënshkruar dy kontrata me dy operator te ndryshëm pasi qe kane qene dy Pjese (Lote).

Për arsye qe ti iket llojllojshmërisë së çmimeve dhe mundësisë qe operatoret ekonomik të ofrojnë çmime te ndryshme për një kopje kollor apo një kopje bardh dhe zi dhe përmes këtyre kalkulimeve te mos arrihet deri te kontrata me çmimin më të volitshëm në përgjithësi është kërkuar nga Operatoret Ekonomik qe konkurrojnë ne këtë procedurë të ofrohet vetëm çmimi për kopje bardh dhe zi dhe pastaj te kalkulohet çmimi për një kopje kollor me çmimin e katër kopjeve bardh dhe zi, kjo ka ndikuar qe Operatoret te ofrojnë çmimin duke llogaritur se sa realisht duhet te jete çmimi për një kopje bardhe dhe zi me te cilën pastaj e kane llogaritur edhe atë kollor dhe totalin e kontratës ne përgjithësi.

Ne do te analizojmë te gjitha shpenzimet qe kane pasur ne te kaluarën disa institucione publike te cilat tashmë e shfrytëzojnë këtë kontrate. Shpenzimet qe kane pasur institucionet publike ne te kaluarën përfshinë te gjitha kostot siç janë blerja e fotokopjeve/printerëve, servisimi i tyre dhe mbi te gjitha kosto e tonerëve, te gjitha këto do te krahasohen me shpenzimet qe tashme krijojnë këto institucione apo thënë më thjesht sa paguajnë për këtë kontratë brenda një viti/muaji.

Theksojmë qe nuk mund te analizohet sasia sa është fotokopjuar/printuar atëherë dhe sa tash por ajo nuk mund te ketë ndonjë ndryshim te theksuar pasi që bëhet fjale për dallimin në mes dy viteve dhe ku nuk ka pasur ndonjë ndryshim te madhe që të ketë lëvizje të theksuar në numrin e kopjeve të dokumenteve dhe gjithsesi me e rëndësishmja për shtetin e Kosovës është të shikohen kursimet monetare ne ketë fushë që edhe është parimi themelor me te cilin është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe procedurat e centralizuara.

Ne vazhdim do te analizojmë shpenzimet e disa institucioneve publike për fotokopje/printim.

1. Policia e Kosovës

Pagesa për një vit e bere nga policia e Kosovës për kontratën Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira është si me poshtë:


Nr.	Fatura mujore nga Art House për Policinë e Kosovës	Vlera
1	Gusht 2018	€ 19,036.12 €
2	Shtator 2018	10,510.89 €
3	Tetor 2018	13,608.35 €
4	Nëntor 2018	8,881.99 €
5	Dhjetor 2018	11,549.41 €
6	Janar 2019	9,642.35 €
7	Shkurt 2019	9,393.02 €
8	Mars 2019	9,642.55 €
9	Prill 2019	10,204.80 €
10	Maj 2019	9,582.10 €
11	Qershor 2019	8,466.12 €
12	Korrik 2019	9,675.92 €
Totali për 1 vit :		130,193.60 €

Pra në total për periudhën 12 mujore prej Gusht 2018 deri Korrik 2019 Policia e Kosovës për shërbime të printimit dhe fotokopjimit janë shpenzuar **130,193.60 €**, ndërsa nëse kalkulojmë shpenzimet e përafërta për fotokopje dhe printer gjate një viti para hyrjes ne fuqi te kësaj kontrate , përkatësisht për vitin 2017, shpenzimet që lidhen me shërbimet e fotokopjimit dhe printimit arrijnë vlerën rreth **375,666.81 €**. Pra kur krahasojmë këto dy periudha 1 vjeçare, del që pas futjes në fuqi të kontratës së AQP-së shpenzimet për fotokopjim dhe printim janë rreth **245,473.21 €** më të ulëta, pra kemi rreth 65% kursim të mjeteve publike.

Shpenzimet e përfaqëta për fotokopje dhe printer gjate një viti nga Policia e Kosovës para hyrjes ne fuqi te kësaj kontrate kemi shpenzimet si me poshtë:

Nr.	Policia e Kosovës	Nr i Prokurimit	Data e nenshkrimi te kontrates	Vlera e parashikuar e kontratës	Vlera e përgjithshme e kontratës	Kohezgjatja	Të shfrytëzuara gjatë 2017 (me mesatare)	Muajt e shfrytëzimit të kontratës
1	FURNIZIM ME TONERA PËR PRINTERA - RIVLERSIM	214 16 147 111	19.12. 2016	€ 334,963.00	€ 301,254.81	vlera per 1 vit	€ 301,254.81	
	Furnizim me tonera per fotokopje- Njoftim Paraprak	14-18-293-1-1-1	Data e njoftimit 01.02. 2018	€ 331,009.72				
2	Kontrata: Furnizim me toner per Printera	214-17-3115-1-2-1	09.04. 2017	€ 25,445.91	€ 10,350.00	vlera per 1 vit	€ 7,762.50	9 muaj
3	Kontrata: Furnizim me toner per Fotokopje	214-17-2611-1-2-1	08.08. 2017	€ 92,923.54	€ 51,555.00	vlera per 1 vit	€ 21,481.25	5 muaj
	Nr. i pjesës: 1				€ 15,952.00	vlera per 1 vit	€ 6,646.67	
	Nr. i pjesës: 2				€ 282.00	vlera per 1 vit	€ 117.50	
	Nr. i pjesës: 3				€ 18,980.00	vlera per 1 vit	€ 7,908.33	
	Nr. i pjesës: 4				€ 75,000.00	Vlera per 3 vite	€ 12,500.00	6 muaj
4	Furnizim me tonera per printera	214-17-1821-1-2-1	07.07. 2017	€ 49,985.00		Vlera per 3 vite	€ 5,060.00	
	Nr. i pjesës: 1				€ 30,360.00			
	Nr. i pjesës: 2							
5	Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: MIRËMBAJTJE, SERVISIM, RIPARIM TË PAJISJEVE TË TI Grupi 1. MIRËMBAJTJA, SERVISIM, RIPARIM I PAJISJEVE FOTOKOPJUESE, Grupi 2. MIRËMBAJTJA, SERVISIM I PAJISJEVE PRINTUESE	214-16-249-2-2-1	01.09. 2017	€ 84,000.00	€ 47,778.00	vlera per 1 vit	€ 11,944.50	3 muaj
					€ 3,965.00	vlera per 1 vit	€ 991.25	
				TOTALI:	€ 555,476.81		€ 375,666.81	

SHPENZIMET 1 VJEÇARE TË POLICISË SË KOSOVËS PËR SHËRBIME TË PRINTIMIT DHE FOTOKOPJIMIT



Nga operatori ekonomik Art House për Policinë e Kosovës janë venë në funksion gjithsej 589 paisje të printimit dhe fotokopjimit.


Nr.	Pershkrimi	Numri i Pajisjeve
1	A4 Printer bardh e zi	156
2	A4 Printer Multifunksional bardh e zi	148
3	A4 Printer Multifunksional me ngjyra	2
4	A4/A3 Fotokopje bardh e zi	63
5	A4/A3 Fotokopje me ngjyra	220
Total:		589

2. Komisioni i Pavarur për Media

Pagesa e bere për një vit nga Komisioni i Pavarur për Media për kontratën Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira është si me poshtë:

Nr.	Fatura mujore nga Art House për Komisionin e Pavarur për Media	Vlera
1	Gusht 2018	€ 30.08
2	Shtator 2018	€ 24.25
3	Tetor 2018	€ 20.26
4	Nëntor 2018	€ 33.21
5	Dhjetor 2018	€ 70.00
6	Janar 2019	€ 37.45
7	Shkurt 2019	€ 24.61
8	Mars 2019	€ 47.59
9	Prill 2019	€ 34.67
10	Maj 2019	€ 44.70
11	Qershor 2019	€ 62.47
12	Korrik 2019	€ 117.47
Totali për 1 vit :		€ 546.75


Shpërndarja e shpenzime nëpër muaj në formë grafike duket si me poshtë:



Ndërsa nëse kalkulojmë shpenzimet e përafërta për fotokopje dhe printer gjatë një viti para hyrjes në fuqi të kësaj kontrate kemi shpenzimet si me poshtë:

Komision i Pavarur i Mediave në vitin 2017 në kontratën për servisimin e printerëve dhe fotokopjeve ka paraparë për një periudhë 36 mujore **3,000€** shpenzime, që nënkupton **1,000€** shpenzime vjetore.

Ndërsa për blerjen e tonerëve në vitin 2017 ka shpenzuar **277.60€**. Pra në total pa shpenzimet e blerjes së printerëve dhe fotokopjeve KPM ka shpenzuar **1,277.60€**, ndërsa përmes kontratës së centralizuar ka shpenzuar **546.75€** në total për 12 muaj (1 vit), pra mesatarisht janë kursyer rreth **730 euro** ose **57%** e parasë publike.



Komisioni i Pavarur për Media ka në shfrytëzim gjithsej 8 paisje të printimit dhe fotokopimit.

Nr.	Përshkrimi	Numri i Pajisjeve
1	A4 Printer me ngjyra	1
2	A4 Printer bardh e zi	2
3	A4/A3 Fotokopje bardh e zi	5
Total:		8

3. Dogana e Kosovës

Pagesa për një vit e bere nga policia e Kosovës për kontratën Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira është si me poshtë:

Nr.	Fatura mujore nga Art House për Doganën e Kosovës	Vlera
1	Qershor 2018	€ 811.87
2	Korrik 2018	€ 1,219.25
3	Gusht 2018	€ 1,694.91
4	Shtator 2018	€ 2,690.57
5	Tetor 2018	€ 1,336.36
6	Nëntor 2018	€ 1,615.15
7	Dhjetor 2018	€ 1,435.67
8	Janar 2019	€ 1,201.57
9	Shkurt 2019	€ 1,101.70
10	Mars 2019	€ 1,322.67
11	Prill 2019	€ 1,329.44
12	Maj 2019	€ 2,542.41
Total:		€ 16,270.45

Ndërsa nëse kalkulojmë shpenzimet e përafërta për fotokopje dhe printer në bazë të kontratave para hyrjes ne fuqi te kësaj kontrate kemi shpenzimet si me poshtë:


Nr.	Doganat e Kosovës	Nr. i Prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Vlera e parashikuar e kontratës	Vlera e përgjithshme e kontratës	Kohëzgjatja
	"Marrja me qira e printereve dhe fotokopjeve"	201 13300-17-3429-1-2-1	Anulim	112,000.00		36 muaj
1	"Marrja me qira e printerëve dhe fotokopjeve"	201 13300-18-12-1-3-6	29.01.2018	9,990.00	9,894.30	3 muaj

Duke marr parasysh që kontrata e mëparshme e implementuar ka qenë kontratë me kohëzgjatje 3 muaj, krahasimi do të bëhet me mesataren 3 mujore të shpenzimeve me kontratën e re, ku shihet që kjo kontratë çdo 3 muaj ka kursyer mesatarisht 53.76% të buxhetit ose 5318.91€ në vlerë monetare.

Kontrata paraprake	Shpenzimet për 1 vit - Kontrata e tanishme	Shpenzimet mesatare për 3 muaj nga kontrata e tanishme	Shuma mesatare e kursyer në euro per 3 muaj	Perqindja e kursimeve me kontratën e re
€ 9,894.30	€ 18,301.57	€ 4,575.39	€ 5,318.91	53.76%

Më poshtë kemi shpërndarjen e shpenzimeve nëpër 3 muajor për një vit pas nënshkrimit të kontratës së re.

Kontrata paraprake 3 muaj	Shpenzimet me kontratën aktuale të AQP-së			
	Qershor- Gusht 2018	Shtator-Nëntor 2018	Dhjetor 2018- Shkurt 2019	Mars-Maj 2019
€ 9,894.30	€ 3,726.03	€ 5,642.08	€ 3,738.94	€ 5,194.52



Këtu mund të shohim se asnjë tremujor gjatë përdorimit të kontratës së AQP-së nuk është afër vlerës së kontratës paraprake të Doganës së Kosovës.


Dallimet janë mjaftë të mëdha edhe pse dy kontratat janë për marrje me qira të pajisjeve fotokopjuese, nga kjo mund të koloadojmë që çmimi më i volitshëm është arritur për shkak të përdorimit të procedurave të centralizuara.

4. Ministria e Ministria e Punëve të Brendshme

Pagesa për një vit e bërë nga Ministria e Punëve të Brendshme për kontratën Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira është si me poshtë:

Nr.	Fatura mujore nga RIKON për MPB-në	Vlera
1	Dhjetor 2018	€ 976.07
2	Janar 2019	€ 1,080.51
3	Shkurt 2019	€ 1,175.95
4	Mars 2019	€ 988.56
5	Prill 2019	€ 866.78
6	Maj 2019	€ 1,050.94
7	Qershor 2019	€ 1,138.75
8	Korrik 2019	€ 1,198.72
9	Gusht 2019	€ 1,193.30
10	Shtator 2019	€ 1,240.72
11	Tetor 2019	€ 1,382.66
12	Nëntor 2019	€ 1,025.13
Totali për 1 vit :		€ 13,318.08

Më poshtë kemi edhe paraqitjen grafike të faturave mujore për periudhën Dhjetor 2018 deri Nëntor 2019:




Shpenzimet e përafërta për fotokopje dhe printer gjatë një viti nga Ministria e Punëve të Brendshme para hyrjes në fuqi të kësaj kontrate kemi shpenzimet si më poshtë:

Titulli		Data e nënshkrimit të kontratës	Kohëzgjatja	Vlera për 3 vite	Vlera e përafërt për vitin 2018
"Mirëmbajtja dhe servisimi i fotokopjuesve, printerëve dhe pajisjeve tjera të TI" Ritender		25.10.2017	36 muaj	€ 10,452.46	€ 3,484.15 (10,452.46/3vite)
Furnizim me tonerë - 214-17-3757-1-1-1/FA019	PJESA (LLOT)-1	19.01.2018	36 muaj	€ 809,186.43	€ 269,728.81 (809,186.43/3vite)
	Pjesa (Lot)-2	18.01.2018	36 muaj	€ 282,790.80	€ 94,263.60 (282,790.80/3vite)
Furnizim me tonerë - 214-17-3757-1-1-1/FA020		20.08.2018	36 muaj	€ 91,704.56	€ 10,189.00 (91,704.56*4/36 muaj)
Totali:				€ 1,194,134.25	€ 377,665.56

Nëse shohim totalin shpenzimeve gjatë vitit 2018 për printim fotokopje dhe skenim brenda një viti është rreth **377,665.56€**, këto shpenzime janë para hyrjes në fuqi të kontratës së AQP-së.

Ndërsa shpenzimet për një vit me kontratën e AQP-së janë **13,318.08€**, diferenca është e jashtëzakonshme duke pasur parasysh që në shpenzimet e vitit 2018 nuk janë përfshirë shpenzimet për blerjen e pajisjeve. Gjithashtu mund të shohim që edhe nëse krahasojmë vetëm shpenzimet për furnizim me toner që kanë qenë rreth 374,180.00€ për një vit dhe shpenzimet me kontratën aktuale të AQP-së që janë 13,318.08€ apo në përqindje shpenzimet aktuale janë vetëm **3.56%** e shpenzimeve paraprake.

Në vlerë monetare kursimet në bazë të këtyre të dhënave janë rreth **364,347.00€** për një vit.



5. Posta e Kosovës

Posta e Kosovës ka nënshkruar një kontratë me titull: “Shërbimi Pay Per Print për zyrat postare të Postës së Kosovës sh.a.”, kontratë kjo përafërsisht e ngjashme me kontratën e AQP-së për fotokopje me qira. Ne tabelën e mëposhtme e keni te paraqitur në formë tabelore komplet sasinë e përafërt të kërkuar nga posta e Kosovës për 36 muaj:

Nr.	Përshkrimi : Shërbimi Pay per Print per zyra Postare te PK-së	Njësia matëse faqe e printuar/kopjuar	Sasia e përafërt
1	Print/Copy A4 - black and white	faqe	20750000
2.	Print/Copy A4 – colour	faqe	30000
3.	Print/Copy A3 - black and white	faqe	6000
4.	Print/Copy A3 - Colour	faqe	3000

Duke supozuar qe printimi i një fletë A4 me ngjyra kushton sa 4 fletë A4 bardh e zi, printimi i një flete A3 bardh e zi kushton 4 here me shume se një fletë A4 bardh e zi, si dhe printimi i një flete A3 me ngjyra kushton sa 4 fletë A3 bardh e zi, atëherë kemi bere këtë llogaritje:

Nr.	Përshkrimi : Shërbimi Pay per Print per zyra Postare te PK-së	Njësia matëse faqe e printuar/kopjuar	Sasia e përafërt	Kuota*	Sasia x Kuota
1	Print/Copy A4 - black and white	faqe	20750000	1	20750000
2	Print/Copy A4 – colour	faqe	30000	4	120000
3	Print/Copy A3 - black and white	faqe	6000	4	24000
4	Print/Copy A3 - Colour	faqe	3000	16	48000
			TOTAL		20942000
			Vlera e Kontratës		126947.13€
			Çmimi për njësi		0.006061844€

Siç shihet edhe Posta e Kosovës ka nënshkruar një kontratë mjaft të leverdishme, me diferenca të vogla pak më të favorshme në çmim krahasuar me kontratën e AQP-së, por jo edhe ne kualitet të shërbimit, pasi qe në kontratën e nënshkruar nga AQP-ja përfshihen edhe dy specifika qe nuk janë tek kontrata e Postes se Kosovës, që e arsyetojnë këtë difference në çmim, e ato janë:

- Softuerit menaxhues dhe kontrollues për Printim, Fotokopjim dhe Skanim:** Solucioni softuerik duhet te kontrolloje qasjen në printerë, fotokopje, skanerë dhe ne pajisje multifunksionale, duhet që të menaxhoj alokimin e kostove me qellim të raportimit si dhe për qëllime të buxhetimit. Softueri menaxhues duhet që të mundësojë një ambient të sigurt të printimit dhe të dokumentimit në mënyrë qe t’iu ndihmoje institucioneve që ta kontrollojnë shfrytëzimin e pajisjeve si dhe shpenzimet e printimit, fotokopjimit dhe skanimit.
- Pajisjet e reja:** Duhet te theksohet qe tek Kontrata e nënshkruar nga AQP është kërkuar qe Operatori ekonomik ti sjell të gjitha Pajisjet e reja, për dallim nga kontrata e Postes qe

nuk ka kërkuar pajisje te reja, kjo ndikon që çmimi i kontratës së AQP-së të jetë pak me i lartë por kjo difference është shumë e vogël dhe duke marr parasysh funksionimin dhe mundësin e kontrollit të shpenzimeve përmes kontrollit të fotokopjeve/printerëve.

Si përfundim gjatë analizimit të këtyre institucioneve është vërejtur që kursimet për shërbimet e printimit/fotokopjimit/skanimit janë minimum mbi 50% nga shpenzimet në vitet paraprake por ka edhe institucione ku kursimet në përqindje janë tre shifrore.

2.2 Kontratat publike - Shfrytëzimi i veturave me qira

AQP ka filluar me procedurat për shfrytëzimin e veturave me qira pas rekomandimit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në raportin me titull “Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare” i vitit 2014. Në këtë raport auditori konkludon që nuk janë duke u shfrytëzuar mundësitë për prokurim të centralizuar si dhe rekomandohet që Ministria e Financave duhet të: Konsiderojë që Agjencisë Qendrore të Prokurimit t’i jepet përgjegjësia e përgjithshme për prokurim të centralizuar sa i përket mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve si dhe të analizojë mundësitë për të përdorur lizingun si alternativë kundrejt blerjes së automjeteve.

Gjithashtu është e domosdoshme të theksohet që ka pasur keqpërdorime të mëdha me servisimin e automjeteve, disa ndonjëse me qëllim të keqpërdorimit e disa nga pakujdesia e zyrtarëve publik të cilën pakujdesi e kanë shfrytëzuar bizneset e kësaj fushe. Me futjen në fuqi të këtyre kontratave ku të gjitha përgjegjësit mbi automjetet (apo pajisjet tjera që merren me qira) janë të kontraktorëve, ulet mundësia e keqpërdorimeve dhe mbi të gjitha rritet siguria e vetë automjeteve zyrtare pasi që jo rrallëherë automjetet e institucioneve publike nuk janë servisuar dhe mirëmbajtur me rregull. Në shumë raste janë paguar shumë mjete për ndërrimin dhe rregullimin e pjesëve të automjeteve. Edhe zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka cekur që në disa raste ka pasur kontrata për servisimin e automjeteve ku çmimet kanë qenë shumë me të larta se çmimet e tregut, ndërsa me kontratat e marrjes me qira nuk ka mundësi të ketë këso lloj shpenzime pasi që shpenzimet dihen në fillim dhe janë fikse mujore. Dukuri të tilla të parregullsive për servisim dhe mirëmbajtje janë shfaqur në raportet e auditorit, ku p.sh në raportin e vitit 2014 raportohet për 268 vetura në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme që presin për servis nga viti 2009, pra siç shihet për servisim të një veture kanë kaluar me shumë se 5 vite. Ndërsa me hyrjen në fuqi të këtyre kontratave këto probleme eliminohen pasi që kontraktuesi është i detyruar të kryej serviset me rregull dhe pa vonesa kohore.

Po ashtu nëse blejmë vetura kemi një risk shumë të madh në rast të ndonjë aksidenti, ku institucionet mbesin pa veturë deri sa vetura të aftësohet për komunikacion, ose në rastin më të keq, kur veturat e dëmtuara nuk mund të aftësohen për komunikacion institucionet duhet të blejnë përsëri veturë. Edhe ky problem është eliminuar me hyrjen në fuqi të këtyre kontratave, pasi që në raste të tilla kontraktori është i detyruar që të aftësojë apo zëvendësojë automjetin jo më larg se dy ditë pune.

Auditori i Përgjithshëm i ka cekur çështjet e mësipërme të mangësive që janë hasur sa i përket servisimit dhe mirëmbajtjes së veturave, në raportin me titull “Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve zyrtare” i vitit 2014. Mangësitë më të mëdha të shfaqura në këtë raport nga ana e auditorit janë:

- 1. Parregullsitë në Implementimin e kontratave** - Tek të gjitha OB-të e audituara, përveç tek PK, fituesi i kontratës ka rezultuar të jetë më i shtrenjtë se OE i pasuksesshëm edhe pse procesi i vlerësimit të tenderëve e ka radhitur fituesin si më të mirin në momentin e vlerësimit sipas parametrave të përcaktuar në DT. Arsyeja pse te PK nuk është gjetur një ndodhi e tillë është për shkak se kontratat janë nënshkruar duke përdorur procedurën e kuotimit të çmimeve në vend të procedurës së hapur.

2011-2013				
Automjeti	Fituesi	OE i pasuksesshëm	Dallimi	Mesatarja vjetore
Nissan	104,455	87,935	16,520	8,260
Toyota	31,404	45,631	-14,227	-7,113
Polo	20,214	20,383	-169	-85
Totali	156,073	153,949	2,124	1,062

Tab. 1: Krahësimi i OE fitues dhe atij të pasuksesshëm në ATK

- 2. Dallimet enorme në çmime për artikuj të njëjtë të blerë nga OB-të e ndryshme** - Këto dallime paraqiten në të gjithë artikujt që janë marrë si mostër për të 5 llojet e automjeteve. Dallimi minimal është 3% derisa ai maksimal është 628%.

Nissan Terrano							
ARTIKULLI	ATK	DOGANA	KGJK	MAP	Çmimi më i ulët	Çmimi më i lartë	Dallimi %
Vaj motori	12	11	29.5	10	10	29.5	195%
Filtër i naftës	12.5	24	63.85	25	12.5	63.85	411%
Filtër i ajrit	15.1	30	63.85	29	15.1	63.85	323%
Filtër i klimës	14.1	36	N/A	45	14.1	45	219%
Filtër i vajit	11.1	24	58.8	21	11.1	58.8	430%
Gurtne frenimi të pasme	167.78	97	90.6	208	90.6	208	130%
Kryqi i kardarit	68.77	35	15	45	15	68.77	358%
Bosh pompa	101.97	222.8	60	N/A	60	222.8	271%
Riparimi i anglasitit/starterit	150	50	145	N/A	50	150	200%
Korpa, drugllagera, llamella (set)	541	435	476.5	490	435	541	19%
Amortizatori i pare	73	55	173.3	N/A	55	173.3	215%
Turbina	576	550	N/A	N/A	550	576	5%

Tab. 2: Krahësimi i çmimeve të një numri të përzgjedhur të artikujve të blerë nga OB-të

3. Çmimet për pjesët e furnizuara kanë qenë më të larta se ato të tregut:

	Shpenzimet aktuale	Çmimi i tregut	Kursimet e mundshme
Totali	156,184	120,352	35,852
ATK	42,670	39,002	3,668
Dogana	88,365	64,688	23,697
KGJK	23,485	15,955	7,530
MAP	1,664	707	957

Tab. 3: Kursimet e mundshme nga shfrytëzimi i çmimit të tregut

4. Variacione ekstreme në çmime mes kontratave të nënshkruara për artikuj të njëjtë nga OB e njëjtë – si shembull janë marr disa artikuj të kontraktuara nga KGJK-ja në tre regjione. Artikujt e ngjashëm janë blerë në regionin e Prizrenit me çmim shumë më të lartë krahasuar me dy regionet tjera.

Nr i artikullit në DT	Përshkrimi	Sasia Prizreni	Çmimi			Dallimi absolut		Dallimi relativ (%)	
			Peja	Gjilani	Prizreni	Peja	Gjilani	Peja	Gjilani
12	Sponat e shkurta	12	30.0	40.0	95.0	65.0	55.0	3.2	2.4
38	Doboshi i parë i rrotës	11	20.0	80.0	182.0	162.0	102.0	9.1	2.3
44	Semeringat e vegjël	65	10.0	20.0	88.0	78.0	68.0	8.8	4.4
49	Semeringat e mëdhenj	14	10.0	30.0	26.0	16.0	(4.0)	2.6	0.9
52	Nxemsa	16	35.0	20.0	109.7	74.7	89.7	3.1	5.5
65	Vaji i ndërruesit (menjaqit)	45	5.0	7.0	28.0	23.0	21.0	5.6	4.0
66	Vaji i reduktorit	63.5	5.0	5.0	28.0	23.0	23.0	5.6	5.6
67	Glicerinë	54	5.0	3.0	18.0	13.0	15.0	3.6	6.0
68	Antifrizi	85	7.0	5.0	14.5	7.5	9.5	2.1	2.9
69	Uji për xhama	94	2.0	1.0	5.6	3.6	4.6	2.8	5.6
96	Rregllazha e rrotëve	22	10.0	15.0	45.0	35.0	30.0	4.5	3.0
100	Llampat e stop dritave	11	1.0	5.0	39.0	38.0	34.0	39.0	7.8

Tabela 4: Dallimet në mes të çmimeve të artikujve të përzgjedhura e të kontraktuara nga KGJKja në tre regjione

5. Përgatitje joadekuate e specifikacionit teknik

6. Përdorim jo adekuat i procedurës së prokurimit - kuotim i çmimeve në vend të procedurës së hapur.

7. **Shpenzime tejet te mëdha për servisimet e rregullta:** çmimet e kontraktuara kanë qenë më të larta sesa çmimi i tregut si dhe janë blerë sasi jo proporcionale të filterëve krahasuar me sasinë e vajit. Një gjë e tillë është hasur tek Ministria e Administratës Publike ku janë bërë shpenzime enorme për të vetmen veturë Nissan Terrano që ka qenë në posedim të tyre.

Nissan Terrano					
ARTIKULLI	Sasia	Çmimi sipas kontratës	Çmimi i tregut	Shuma sipas kontratës	Shuma sipas tregut
Vaj motori	8	10	8	80	64
Filtër i naftës	8	25	22	200	176
Filtër i ajrit	8	29	13	232	104
Filtër i klimës	8	45	15	360	120
Filtër i vajit	8	21	12	168	96
Gurtne frenimi të pasme	3	203	49	624	147
Gjithsej				1,664	707
Kursimi i mundshëm					937

Tab.6 Shpenzimet e MAP për servisimin e një veture

8. **Vlera e riparimeve më e lartë se vlera e mbetur** - Tabela në vijim paraqet shpenzimet për mirëmbajtje dhe riparim të 20 automjeteve për tre vite 2011-2013. Ne kemi paraqitur vetëm rastet që kemi identifikuar ku vlera e riparimeve ishte mbi 10,000 euro vetëm për tre vite, e ne disa raste vlera e riparimeve e tejkalon vlerën e mbetur të automjeteve.

Nr.	Tipi i automjetit	Data e pranimit	Vlera blerëse (€)	Vlera e riparimeve për tri vite (€)	Çmimi mesatar i tregut për automjet të ri sipas katalogut doganor (€)
1.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2004	26,111.30	17,301	51,500
2.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2004	26,111.30	19,596	51,500
3.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2004	26,111.30	17,502	51,500
4.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2004	26,111.30	17,444	51,500
5.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2004	26,111.30	17,424	51,500
6.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2004	26,111.30	17,066	51,500
7.	VW Komb 2.5 Tdi 4- Motion	20.12.2004	26,111.30	14,655	41,233.50
8.	Toyota Land Cruiser 120	23.01.2005	26,111.30	19,458	51,500
9.	Hyundai Santa Fe	21.04.2005	15,690.00	20,526	31,700
10.	Toyota Land Cruiser 120	12.09.2005	26,111.30	32,466	51,500
11.	Toyota Land Cruiser 120	08.12.2005	26,111.30	17,149	51,500
12.	Toyota Land Cruiser 120	08.12.2005	26,111.30	21,074	51,500
13.	Toyota Land Cruiser 120	08.12.2005	26,111.30	19,360	51,500
14.	Toyota Land Cruiser 120	08.12.2005	26,111.30	16,719	51,500
15.	Toyota Land Cruiser 120	08.12.2005	26,111.30	16,462	51,500
16.	Toyota Land Cruiser 120	08.12.2005	26,111.30	16,074	51,500
17.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2006	26,111.30	22,609	51,500
18.	Toyota Land Cruiser 120	20.12.2006	26,111.30	19,103	51,500
19.	VW Golf 1.9 TDI Trendeline	25.06.2008	20,910.00	12,643	23,125
20.	VW Golf 1.9 TDI Trendeline	25.06.2008	20,910.00	11,822	23,125

Tab. 5: Vlera e riparimeve më e madhe se 10000€.

Duke u bazuar në të dhënat dhe rekomandimet e këtij raporti të auditimit Ministria e Financave i ka dhënë kompetenca AQP-së që përpos blerjes të veturave të bëjë edhe prokurime te centralizuara për marrjen e veturave me qira.

Ne kuadër të këtij grupi të kontratave, AQP i ka ndarë veturat e marra me qira ne tre (3) kategori varësisht nga specifikat e kërkuara nga autoritetet qe janë pjesë e kontratës. Gjithsej janë iniciuar tre procedura te prokurimit me nga 2 lote me numër te prokurimit si ne vijim:

1. AQP 17 006/1-111 – Kategoria I
2. AQP 17 006/2-111 – Kategoria II
3. AQP 17 006/3-111 – Kategoria III

Përgjegjësitë e Kontraktuesit për këto kontrata janë:

- Kontraktuesi duhet të bëjë kontrollimin teknik,
- Sigurimin,
- Regjistrimin,
- Servisimin e rregullt apo sipas nevojave,
- Ndërrimin e gomave verore dhe dimërore,
- Mirëmbajtjen, riparimin dhe çdo shpenzim tjetër gjatë periudhës 5 vjeçare,
- Sigurimi kasko është obligim i kontraktuesit,
- Ne rast të defektit të automjetit, kontraktuesi obligohet që brenda periudhës sa më të shkurt të aftësoj apo zëvendësoj automjetin, jo me larg se dy dit pune,
- Ne rast se automjeti është i dëmtuar dhe nuk mund të aftësohet për komunikacion atëherë zëvendësohet prej kontraktuesit me automjet tjetër por jo më të vjetër se 5 vite.

Bazuar ne përgjegjësitë e kontraktuesit ne kemi këto kosto për një veturë të marrë me qira të kategorisë 1 - Dacia Sandero:

Kategoria 1

	Sasia	Çmimi për njësi për 1 muaj	Çmimi për njësi për 1 vit	Çmimi për njësi për 66 muaj	Çmimi total për 1 muaj	Çmimi total për 1 vit	Çmimi total për 66 muaj
Lot 1	78	€ 247.00	€ 2,964.00	€ 16,302.00	€ 19,266.00	€ 231,192.00	€ 1,271,556.00
Lot 2	76	€ 247.00	€ 2,964.00	€ 16,302.00	€ 18,772.00	€ 225,264.00	€ 1,238,952.00
Total	154	€ 247.00	€ 2,964.00	€ 16,302.00	€ 38,038.00	€ 456,456.00	€ 2,510,508.00

Ndërsa nëse një veturë e tillë do të ishte blerë atëherë minimalisht për periudhën 66 mujore do të ishin këto shpenzime në këto shpenzime nuk është përfshirë rreziku i ndonjë prishje më të madhe që do të krijonte shpenzime te mëdha:

Kategoria 1

Dacia Sandero	Vlera minimale	Sasia e kërkuar brenda periudhës	Çmimi total
Çmimi i blerjes	€ 12,500.00	1	€ 12,500.00
Kontrollimi teknik	€ 30.00	6	€ 180.00
Sigurimi	€ 108.56	6	€ 651.36
Kasko	€ 290.00	6	€ 1740.00
Regjistrimi	€ 77.00	6	€ 462.00
Goma Verore	€ 40.00	4*2=8	€ 320.00
Goma Dimërore	€ 50.00	4*2=8	€ 400.00
Servisi i rregullt	€ 90.00	5*2=10	€ 900.00
Ndërrimi i pjesëve rezervë	€ 80.00	6	€ 480.00
Rregllazha	€ 10.00	2	€ 20.00
Shpenzimet e blerjes dhe mirëmbajtës për veturë			€ 17,653.36

Bazuar ne përgjegjësit e kontraktuesit ne kemi këto kosto për një veturë të marrë me qira te kategorisë 2 -Renault Megan:

Kategoria 2

	Sasia	Çmimi për njësi për 1 muaj	Çmimi për njësi për 1 vit	Çmimi për njësi për 66 muaj	Çmimi total për 1 muaj	Çmimi total për 1 vit	Çmimi total për 66 muaj
Lot 1	102	€ 347.00	€ 4,164.00	€ 22,902.00	€ 35,394.00	€ 424,728.00	€ 2,336,004.00
Lot 2	102	€ 347.00	€ 4,164.00	€ 22,902.00	€ 35,394.00	€ 424,728.00	€ 2,336,004.00
Total	204	€ 347.00	€ 4,164.00	€ 22,902.00	€ 70,788.00	€ 849,456.00	€ 4,672,008.00

Ndërsa nëse një veturë e tillë do të ishte blerë atëherë minimalisht për periudhën 66 mujore do të ishin këto shpenzime në këto shpenzime nuk është përfshirë rreziku i ndonjë prishje më të madhe që do të krijonte shpenzime te mëdha:

Kategoria 2

Renault Megan	Vlera minimale	Sasia e kërkuar brenda periudhës	Çmimi total
Çmimi i blerjes	€ 19,900.00	1	€ 19,900.00
Kontrollimi teknik	€ 30.00	6	€ 180.00
Sigurimi	€ 108.56	6	€ 651.36
Kasko	€ 469.64	6	€ 2,817.84
Regjistrimi	€ 77.00	6	€ 462.00
Goma Verore	€ 40.00	4*2=8	€ 320.00
Goma Dimërore	€ 50.00	4*2=8	€ 400.00
Servisi i rregullt	€ 90.00	5*2=10	€ 900.00
Rregllazha	€ 10.00	2	€ 20.00
Ndërrimi i pjesëve rezerve	€ 100.00	6	€ 600.00
Shpenzimet e brejës dhe mirëmbajtës për veturë te tille			€ 26,251.20

Bazuar ne përgjegjësit e kontraktuesit ne kemi këto kosto për një veturë te kategorisë Peugeot të marrë me qira :

Kategoria 3

	Sasia	Çmimi për njësi për 1 muaj	Çmimi për njësi për 1 vit	Çmimi për njësi për 66 muaj	Çmimi total për 1 muaj	Çmimi total për 1 vit	Çmimi total për 66 muaj
Lot 1	39	€ 497.96	€ 5,975.52	€ 32,865.36	€ 19,420.44	€ 233,045.28	€ 1,281,749.04
Lot 2	39	€ 497.96	€ 5,975.52	€ 32,865.36	€ 19,420.44	€ 233,045.28	€ 1,281,749.04
Total	78	€ 497.96	€ 5,975.52	€ 32,865.36	€ 38,840.88	€ 466,090.56	€ 2,563,498.08

Ndërsa nëse një veturë e tillë do të ishte blerë atëherë minimalisht do të ishin këto shpenzime:


Kategoria 3

Peugeot 508	Vlera minimale	Sasia e kërkuar brenda periudhës	Çmimi total
Çmimi i blerjes	€ 38,000.00	1	€ 38,000.00
Kontrollimi teknik	€ 30.00	6	€ 180.00
Sigurimi	€ 185.00	6	€ 1,110.00
Kasko	€ 760.00	6	€ 4,560.00
Regjistrimi	€ 77.00	6	€ 462.00
Goma Verore	€ 60.00	4*2=8	€ 480.00
Goma Dimërore	€ 70.00	4*2=8	€ 560.00
Servisi i rregullt	€ 90.00	5*2=10	€ 900.00
Rregllazha	€ 10.00	2	€ 20.00
Ndërrimi i pjesëve rezerve	€ 150.00	6	€ 900.00
Shpenzimet e brejës dhe mirëmbajtjes për veturë të tilla			€ 47,172.00

Nëse krahasojmë koston e përgjithshme të një veturë të marrë me qira nga AQP për 66 muaj (duke pasur parasysh përgjegjësitë e kontraktuesit) dhe shpenzimet minimale të supozuara për blerjen dhe mirëmbajtjen e një veturë të llojit të njëjtë, atëherë varësisht nga lloji i veturës kursimi do të jetë si më poshtë:

Shpenzimet për 1 veturë për 66 muaj				
	Blerje dhe shpenzimet tjera	Marrje me qira	Kursimi	
Kategoria 1	€ 17,653.36	€ 16,302.00	€ 1,351.36	8.29%
Kategoria 2	€ 26,251.20	€ 22,902.00	€ 3,349.20	14.62%
Kategoria 3	€ 47,172.00	€ 32,865.36	€ 14,306.64	43.53%


Kurse në paraqitje grafike shpenzimet për një veturë duken kështu:




Këtu shihet se kursimi më i madh është tek veturat e kategorisë së tretë diku rreth 43.53%, kurse tek dy kategoritë tjera është më i vogël, përkatësisht tek kategoria e parë 8.29% dhe tek kategoria e dytë është 14.62%. Kur shikojmë numrin total të veturave atëherë shpenzimet totale do të jenë rreth € 9,746,014.08 për marrje me qira dhe përafërsisht € 11,753,278.24 për blerje dhe shpenzime tjera, për 66 muaj aq sa është kohëzgjatja e kontratës, shpenzime këto të shpërndara nëpër kategori si në tabelën e mëposhtme:

Shpenzimet për të gjitha veturat për 66 muaj					
	Sasia	Blerje dhe shpenzimet tjera	Marrje me qira	Kursimi	
Kategoria 1	154	€ 2,718,617.44	€ 2,510,508.00	€ 208,109.44	8.29%
Kategoria 2	204	€ 5,355,244.80	€ 4,672,008.00	€ 683,236.80	14.62%
Kategoria 3	78	€ 3,679,416.00	€ 2,563,498.08	€ 1,115,917.92	43.53%
Totali	436	€ 11,753,278.24	€ 9,746,014.08	€ 2,007,264.16	20.60%

Kurse në paraqitje grafike shpenzimet për të gjitha veturat për 66 muaj duken kështu:



Nëse krahasojmë shpenzimet për marrjen me qira të veturave për 66 muaj (duke marr parasysh të gjitha përgjegjësitë e kontraktuesit) dhe shpenzimet minimale për blerjen, sigurimin, mirëmbajtjen dhe shpenzimet tjera, për sasinë e njëjtë të veturave atëherë kursimi do të jetë rreth €1,274,644.80 ose rreth 13.08%. Më poshtë kemi edhe paraqitjen grafike të shpenzimeve dhe kursimeve të mundshme:



Në secilin rast të mësipërm është kalkuluar kosto e përafërt e secilit lloj të automjetit por një fakt që duhet të merret parasysh me rastin e marrjes me qira të automjeteve është edhe fakti që nuk bëhet pagesa e plotë si me rastin e blerjes por pagesat bëhen në periudha mujore. Për të parë se si do të ndikonte në buxhetin e shtetit të Kosovës blerja e këtyre veturave duke mos shfrytëzuar opsionin e marrjes me qira do të shohim më poshtë:

Kategoritë	Sasitë	Çmimi për njësi	Çmimi Total
Kategoria 1	154	€ 12,500.00	€ 1,925,000.00
Kategoria 2	204	€ 19,900.00	€ 4,059,600.00
Kategoria 3	78	€ 38,000.00	€ 2,964,000.00
Totali			€ 8,948,600.00

Bazuar ne te dhënat e përafërta mbi çmimin e tregut te secilit nga llojet e veturave te cilat janë marr me qira vlerësojmë qe për te blere te gjithë këto automjete buxheti i shtetit te Kosovës do te duhej te ndante afro 9 milion euro për blerjen e veturave, me ndarjen e këtyre shpenzimeve ne baza mujore duke pasur afat prej 66 muajve krijohet mundësi për shfrytëzimin e mjeteve financiare ne projekte tjera.

Këto lloj kontrata nuk kane filluar se zbatuari fillimisht ne Kosove por vendet me te zhvilluara si dhe kompanitë multinacionale i kane përdorur këto kontrata shume kohe para shtetit te Kosovës.

Nuk është saktësisht e nivelit te njëjtë por duhet te theksohet qe marrja me qira e një veture ne sektorin privat nga personat privat ka koston prej minimum 25 euro ne dite qe do te thotë afërsisht 750 euro ne muaj. Është e natyrshme qe te vlerësohet qe çmimi ne këto raste është me i larte pasi qe nuk është e sigurte qe për një veture do te merret me qira çdo dite por gjithashtu veturat te cilat kane koston 25 euro ne dite janë vetura ne përgjithësi te vjetra dhe qe nuk ofrojnë komoditetin dhe sigurinë e veturave te cilat janë marre me qira nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Një përparësi tek blerja e veturave është edhe vlera e mbetur e veturave pas 66 muajve, por kjo bazuar ne përvojën e institucioneve publike te Kosovës nuk ka treguar rezultate te kënaqshme pasi qe ne te shumtën e rasteve veturat e institucioneve publike e kane humbur vlerën e tyre duke u zhvlerësuar tërësisht apo edhe duke u shitur për çmime shume te lira.

Qeveria e Kosovës me vendimin nr. 03/13 të datës: 12.02.2015 Autorizohet Ministria e Administratës Publike për organizimin e shitjes së automjeteve përmes ankandit. Në Nëntor 2018 MAP ka konfirmuar që në gjitha institucionet e Republikës janë gjithsej njëqind e tetë vetura që s'përdoren fare nga zyrtarët shtetëror. Këto vetura i përkasin këtyre institucioneve:

Institucionet	Numri i veturave
Ministria e Infrastrukturës	20
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	5
Ministria e Financave	12
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5
Ministria e Administratës Publike	12
Ministria e Shëndetësisë	3
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	10
Zyra e Kryeministrit të Kosovës	9
Agjencia e Statistikave të Kosovës	6
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	26
Totali	108

Të njëjtat janë të vendosura në oborrin e ekzekutivit dhe tek ish-objekti i Rilindjes. Po ashtu, të gjitha veturat në fjalë janë jashtë përdorimit dhe bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare kanë vlerën 0. Pra këto vetura përpos që kanë vështirësi të madhe që të shiten, zënë edhe shumë vend në parkingjet e institucioneve.

Edhe tek veturat si tek çdo lloj i pajisjeve tjera kontratat e centralizuara dhe sidomos ato të marrjes me qira kane ndikim shumë të mire tek institucionet më të vogla të cilat kane numër më të vogël të pajisjeve, në këtë rast të automjeteve, për arsye se institucione e tilla zakonisht kanë hasur ne probleme për te arritur tek kontratat me çmime te tregut për servisimin e automjeteve te tyre.

Si përfundim, AQP rekomandon që të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit për marrje të veturave me qira, sepse implementimi i këtyre kontratave ka sjellë përfitime mjaft të mëdha si ekonomike ashtu edhe në mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e pasurive të institucioneve publike, në këtë rast veturave. Me anë të këtyre kontratave mundësohet që shpenzimet për automjete të jenë të shpërndara nëpër muaj përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, pra nuk nevojitet që në një moment të caktuar kohorë të bëhen shpenzime të mëdha, pra në rastin e blerjes së veturave. Shpenzimet janë të njëjta çdo muaj dhe në to përfshinë sigurimin, sigurimi kasko, regjistrimin, servisimin e rregullt apo sipas nevojave, ndërrimin e gomave verore dhe dimërore, mirëmbajtjen, riparimin dhe çdo shpenzim tjetër gjatë periudhës 5 vjeçare etj., kjo mundëson që të ketë më pak procedura të prokurimit, pra mund të eliminohen procedurat për sigurime, servisim dhe mirëmbajtje, furnizim me goma etj., që rrjedhimisht krijon përfitime ekonomike për arsye se është kontratë më gjithëpërfshirëse që rezulton të jetë edhe më e lirë, po ashtu pamundësohet që të bëhen keq shfrytëzim i parasë publike në rastet e servisimit të veturave.

2.3 Kontratat publike kornizë – Shërbimet e Transportit Ajror

Agjencia Qendrore e Prokurimit gjate vitit 2018 ka zhvilluar procedurën e prokurimit Shërbimet e transportit ajror dhe me datën 23.11.2018 ka nënshkruar kontratën.

Kjo kontratë parasheh qe çmimet e biletave te jene çmimet e tregut në kohë reale dhe Operatorët Ekonomik kanë ofertuar vetëm me “Tarifa e Shërbimit (service charge)”, ku operatori fitues ka ofruar çmimin për tarifën e shërbimeve 3€ për një bilete.

Ne kontratë është cekur shumë çart se si kalkulohet çmimi i biletës qe është çmimi nga sistemi kompjuteri i rezervimit AMADEUS, GALILO, SABRE apo sisteme tjera te barasvlershme plus Tarifa e shërbimit.

Për te pasur mundësi qe te kontrollohen te gjitha faturat nga te gjitha institucionet publike me kontratë është vendosur qe punëtori te pranohet ne pune nen mbikëqyrjen e zyrtareve nga Agjencia Qendrore e Prokurimit dhe ai punëtor do te vendoset me zyre ne AQP dhe kur do qe AQP apo ndonjë institucion tjetër publik ka dyshime mbi çmimin e biletës mund te verifikoj ne prezencë çmimin e bilete te ofruar nga sistemi kompjuteri i rezervimeve te biletave.

Duke pasur parasysh qe nuk ka pasur kontrata te kësaj natyre me herët ne institucionet publike nuk është e mundur te bëjmë krahasimin ne mese kësaj kontrate dhe kontratave tjera por gjithsesi çmimi për Tarifën e Shërbimit prej 3 euro është çmimi shume i arsyeshëm duke pasur parasysh edhe shpenzimet e kontraktorit i cili duhet te paguaj pagat e dy punonjësve qe janë te angazhuar për këtë kontratë.

Një krahasim mund te behet me sektorin privat ku ne te shumtën e rasteve Tarifa e Shërbimit është me e lart se 20 euro për një bilete. Këtë mund ta konstatojmë duke u bazuar ne faktet e me poshtme:

Bazuar ne praktikën ndërkombëtare nuk është ndonjë mundësi me e mire e lidhjes se një kontratë për shërbimet e transportit ajror, çdo kontratë ku çmimet do te ishin fikse nuk është e pëlqyeshme pasi qe do te dëmtohet buxheti i institucioneve publike apo do te dëmtohet përfituesi i kontratës por i cili mund te dëmtohet vetëm ne nje periudhe afatshkurtër dhe nëse vazhdon rritja e çmimit te biletave është e natyrshme qe ai te tërhiqet nga kontrata apo edhe te dështojë si biznes gjë e cila nuk do te duhej te ishte e dëshirueshme nga shteti i Kosovës.

2.4 Kontratat publike kornizë – Furnizim me karburante

AQP ka nënshkruar edhe kontratë të centralizuara për Furnizim me Karburante, kontratë kjo e ndarë në 5 Pjesë (Lote), që ka hyrë në fuqi me 12.07.2019 dhe përfundon me 11.07.2022. Kjo kontratë përdoret nga 86 Autoritete Kontraktuese ku gjithsej janë parashikuar të shpenzohen 26,298,000 Litra Naftë dhe 1,518,100 litra Benzinë. Në dy pjesët (lotet) e para Primi për litër është 0.093€ për Dizell dhe Benzinë, kurse në pjesët (lotet) 3, 4 dhe 5 Primi është 0.0909€ për litër.

		Sasia e parashikuar për 3 vite	
Emri i autoritetit Kontraktues	Njësia matëse	Disel për vetura, gjenerator, nxehtë dhe mjete tjera lëvizëse 10ppm	Benzine vetura dhe gjenerator
Lot 1 (1 AK)	Litra	9705000	435000
Lot 2 (27 AK)	Litra	5470200	433000
Lot 3 (24 AK)	Litra	1130900	236900
Lot 4 (26 AK)	Litra	2590000	344200
Lot 5 (8 AK)	Litra	7401900	69000
Gjithsej 86 Autoritete Kontraktuese		26298000	1518100

Duke analizuar çmimet e kontratës dhe çmimet e tregut për 3 muaj pas hyrjes në fuqi, del që në Pjesët 1 dhe 2 për Naftë kemi mesatarisht kursim prej 0.1044€ për çdo litër, kurse për Benzinë kursimi mesatarë për litër është 0.1548€, ndërsa në Pjesët 3, 4, dhe 5 kursimi për çdo litër Naftë është 0.0935€ dhe për Benzinë është 0.1423€ krahasuar me çmimin e tregut.

HIB PETROL		Data:	AQP-18-001-115		Lot 1, 2	
		12.02.2019				
LOT 1 dhe 2	Disel			Benzinë		
Muaji	Çmimi sipas kontratës	Çmimi i tregut me date 15	Diferenca	Çmimi sipas kontratës	Çmimi i tregut me date 15	Diferenca
GUSHT 2019	€ 1.0399	€ 1.17	€ (0.1301)	€ 1.0157	€ 1.180	€ (0.1643)
SHTATOR 2019	€ 1.0736	€ 1.17	€ (0.0964)	€ 1.0352	€ 1.175	€ (0.1398)
TETOR 2019	€ 1.0634	€ 1.15	€ (0.0866)	€ 1.0197	€ 1.180	€ (0.1603)
Mesatarja:	€ 1.0590	€ 1.1633	€ (0.1044)	€ 1.0235	€ 1.1783	€ (0.1548)

	Petrol Company	Data: 02.05.2019	AQP-18-001-115	Lot 3, 4, 5		
LOT 3,4,5	DISEL			BENZIN		
Muaji	Çmimi sipas kontratës	Çmimi i tregut me date 15	Diferenca	Çmimi sipas kontratës	Çmimi i tregut me date 15	Diferenca
GUSHT 2019	€ 1.0374	€ 1.15	€ (0.1126)	€ 1.0132	€ 1.170	€ (0.1568)
SHTATOR 2019	€ 1.0711	€ 1.15	€ (0.0789)	€ 1.0327	€ 1.160	€ (0.1273)
TETOR 2019	€ 1.0609	€ 1.15	€ (0.0891)	€ 1.0172	€ 1.160	€ (0.1428)
Mesatarja:	€ 1.0565	€ 1.1500	€ (0.0935)	€ 1.0210	€ 1.163	€ (0.1423)

Duke supozuar që ky trend i diferencës mesatare në mes çmimeve mesatare të kontratës dhe atyre të tregut do të jetë i njëjtë deri në fund të kontratës, atëherë kursimet e mundshme do jenë si më poshtë:

Lot 1	Naftë	Benzinë
Sasia e parashikuar për 3 vite	9705000	435000
x Diferenca ne Çmim	€ 0.1044	€ 0.1548
Kursimi mesatar - TOTAL	€ 1,013,202.00	€ 67,338.00

Lot 2	Naftë	Benzinë
Sasia e parashikuar për 3 vite	5470200	433000
x Diferenca ne Çmim	€ 0.1044	€ 0.1548
Kursimi mesatar - TOTAL	€ 571,088.88	€ 67,028.40

Lot 3	Naftë	Benzinë
Sasia e parashikuar për 3 vite	1130900	236900
x Diferenca ne Çmim	€ 0.0935	€ 0.1423
Kursimi mesatar - TOTAL	€ 105,739.15	€ 33,710.87

Lot 4	Naftë	Benzinë
Sasia e parashikuar për 3 vite	2590000	344200
x Diferenca ne Çmim	€ 0.0935	€ 0.1423
Kursimi mesatar - TOTAL	€ 242,165.00	€ 48,979.66

Lot 5	Naftë	Benzinë
Sasia e parashikuar për 3 vite	7401900	69000
x Diferenca ne Çmim	€ 0.0935	€ 0.1423
Kursimi mesatar - TOTAL	€ 692,077.65	€ 9,818.70

Pra, në total nga të gjithë sasinë e parashikuar kursimi del te jetë rreth **2,851,148.31€**, prej tyre **€ 2,624,272.68** në Naftë dhe **€ 2,851,148.31** në Benzinë.

Kursimet për lote	Naftë	Benzinë	Total
Lot 1	€ 1,013,202.00	€ 67,338.00	€ 1,080,540.00
Lot 2	€ 571,088.88	€ 67,028.40	€ 638,117.28
Lot 3	€ 105,739.15	€ 33,710.87	€ 139,450.02
Lot 4	€ 242,165.00	€ 48,979.66	€ 291,144.66
Lot 5	€ 692,077.65	€ 9,818.70	€ 701,896.35
Total	€ 2,624,272.68	€ 226,875.63	€ 2,851,148.31

2.5 Kontratat publike kornizë – Furnizim me Mazut

Në kuadër të prokurimeve të centralizuar AQP gjatë vitit 2018 ka zhvilluar procedurën e prokurimit Furnizim me Mazut për Autoritetet Kontraktuese sipas UA 06/2018 dhe me datë 23.11.2018 ka nënshkruar kontratën. Kontratë kjo me kohëzgjatje tre vjeçare dhe me sasi të parashikuar 3661 ton.

Kjo kontratë ka realizuar të jetë mjaft e favorshme pasi që premiumi për ton është vetëm 62.33€, Premium ky që i shtohet çmimit të një toni Mazut të caktuar në bazë të Berzës mesatare mujore. Pas llogaritjes së çmimeve në këtë mënyrë kemi çmimet mujore për vitin 2019 si më poshtë:

Muaji	Çmimi
Janar	770.4464
Shkurt	810.3662
Mars	816.09429
Prill	825.8851
Maj	787.37044
Qershor	919.82620
Korrik	938.71462
Gusht	880.21286
Shtator	878.07208
Tetor	889.87400
Çmimi mesatar	847.44313

E vetmja kontratë tjetër për Furnizim me Mazut e krahasueshme me kontratën e nënshkruar nga AQP është ajo e nënshkruar nga KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a., kontratë kjo që sipas hulumtimit të KDI-së del të jetë 72% më e shtrenjtë sesa kontrata e nënshkruar nga AQP. Për çdo ton mazut të blerë KEK do të paguaj 107.21€ për premiumin dhe shpenzime të transportit, kurse AQP paguan vetëm 62.33€ për 1 ton mazut të blerë. Ky dallim prej 44.88€ në çmim do të ndikonte që të kurseheshin 448,800.00€ në rast se KEK do të blinte 10,000 ton mazut (aq sa është parashikuar) me premiumin e njëjtë sikur AQP.

Konkluzione

- 1 Me anë të procedurave të centralizuara zvogëlohet numri i procedurave të prokurimit, gjë që është më efikase si në kohë ashtu edhe në anën financiare pasi që një sasi më e madhe e kërkuar do të duhej të sjell çmim më të lirë. P.sh. procedura e marrjes së veturave me qira e realizuar nga AQP me anë të një procedure të prokurimit, janë eliminuar shumë procedura të prokurimit që do të duhej të zhvillonin 160 AK: për blerjen e veturave; për mirëmbajtjen e veturave; për blerjen e gomave; për blerjen e policave të sigurimeve; për regjistrimin dhe kontrollet teknike; pra për të gjitha këto shërbime do të duhej të zhvilloheshin rreth 800 procedura të prokurimit dhe kjo për 36 muaj ndërsa kontrata e AQP-se është për 66 muaj, kjo do të thotë që do të duhej të zhvilloheshin rreth 1600 procedura të prokurimit. Edhe kontrata e fotokopjeve me qira është e përafërt me kontratën e automjeteve me qira pasi që edhe aty përfshihen blerja e fotokopjeve/printerëve, blerja e tonerëve dhe mirëmbajtja e fotokopjeve/printerëve. Ndërsa për secilën kontratë e tjera të AQP-së nëse do të zhvilloheshin procedurat e prokurimit nga vet AK do të duhej të zhvilloheshin minimum 160 procedura të prokurimit.
- 2 Tek secila kontratë e centralizuar e analizuar në këtë punim ka kursime të buxhetit të Republikës së Kosovës.
- 3 Procedurat e centralizuara monitorohen nga më shumë palë të jashtme dhe është më lehtë të monitorohet një procedurë e centralizuar se sa monitorimi i të gjitha procedurave nëse do të zhvilloheshin nga vet AK.
- 4 Duke analizuar përfundimin e kontratave të Agjencisë Qendrore të Prokurimit për të cilat ka ngritur shqetësime auditori i përgjithshëm tek Raporti i Auditimit të Performancës të vitit 2018 se do të shkaktohen humbje buxhetore nëse nuk realizohet 70% i kontratës shohin që AQP ka marrë masa për këto shqetësime dhe ka nënshkruar konkluzione me operatorët ekonomik për përfundimin e kontratave ku ceket që asnjëra palë nuk ka obligime ndaj palës tjetër.
- 5 Kërkesat teknike dhe kriteret tjera profesionale të dosjeve të AQP-së hartohen nga komisionet e formuara nga ekspertet e disa institucioneve që len të kuptohet që do të jenë më profesionale se nëse të njëjtat do të hartoheshin vetëm nga ekspertet e një institucioni.

Rekomandime

Duke marr në konsiderate të gjeturat nga kontratat paraprake të AK-se, të dhënat që AQP disponon si dhe përfitimet e konstatuara si më lartë nga kontratat e nënshkruara nga AQP nga implementimi i prokurimeve të centralizuara nga AQP, rekomandohet, që:

1. Të vazhdohet me implementimin e prokurimeve të centralizuara nga AQP, duke marrë parasysh këtu në radhë të parë përfitimet financiare;
2. Të vazhdohet me implementimin e prokurimeve të centralizuara nga AQP për një implementim dhe menaxhim me të mirë dhe konform kërkesave ligjore të procesit të aktivitetit të prokurimit;
3. Të rritet bashkëpunimi në mes të AK dhe AQP, për një implementim të suksesshëm të këtyre kontratave.
4. Të ketë një bashkëpunim të ngushtë AQP-AK-se, sa i përket monitorimit të realizimit të kontratave nga prokurimet e centralizuara të udhëhequra nga AQP.
5. Të vazhdohet me përdorimin e kontratave publike për marrje me qira të pajisjeve të ndryshme duke përfshirë edhe pajisje mjekësore sipas praktikave të BE-së,
6. Rritjen e listës së prokurimeve qendrore duke përfshirë: ndriçimet publike; deratizim, dezinfektim dhe dezinfektim; shërbime pastrimit; sigurime etj..
7. Të vazhdohet me përdorimin e kontratave publike për shërbimet e transportit ajror duke u bazuar në çmimin e Tarifave të Shërbimeve.
8. Duke parë strukturën e Agjencive Qendrore në shtetet e zhvilluara konsiderojmë që AQP duhet të rritet si nga ana e numrit të zyrtareve ashtu edhe në aspektin profesional.
9. Udhëzimi Administrativ të aprovohet në fillim të vitit dhe jo më vonë.